



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDËTIT PUBLIK

## BULETINI MUJOR I SEMUNDSHMERISE INFEKTIVE (Pasqyra 14 Sh)

SEKTORI I EPIDEMIOLOGJISE

PRILL, 2018

Buletini mujor i sëmundshmërisë infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Epidemiologjisë, Instituti i Shëndetit Publik. Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Ai plotësohet ne pasqyrën ne formatin EXCEL dhe dërgohet me postë elektronike dhe me poste zyrtare në DEKSI, Instituti i Shëndetit Publik, brenda datës 10 te çdo muaji. Te dhënat e agreguara te pasqyrës 14 sh për muajin Prill janë te dhënat e raportuara nga te 36 rrethet e vendit.

### ➤ Semundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjate muajit Prill 2018 zënë 26.6% te totalit te sëmundjeve infektive te raportuara me ane te Pasqyrës 14 sh dhe paraqesin një incidence 168.38/100.000 banorë. Rrethi i Shkodrës mban peshën kryesore te incidences se Salmonelozes jotifoide dhe Shigelozes për muajin Prill 2018 ne nivel kombëtar përkatësisht me incidente 1.11/10.000 banore dhe 1.46/10.000 banore. Vlen te përmendet prekja e moshave femnore përkatësisht < 1 vjeç dhe 1-4 vjeç. Duke ju referuar raportimeve te toksikoinfeksioneve alimentare gjate muajit mars 2018 ne nivel kombëtar incidenca është 4.11/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë dhe Kukës mbajnë peshën kryesore ne raportimin e toksikoinfeksioneve alimentare. Te gjitha rastet janë sporadike, nuk kane patur lidhje epidemiologjike me njeri tjetrin dhe nuk kane qene pjese e ndonjë shpërthimi. Incidenca e gastroenteriteve te paspecifikuara ne nivel kombëtar është 161.63/100.000 banore. Gastroenteritet e paspecifikuar janë te shpërndara ne te gjitha rrethet e vendit.

Tabela 1: Sëmundjet diarreike ne Prill 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Prill 2018	Incidenca Prill 2018 (raste/100.000 banore)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	31	1.11
Shigeloze (Disenteri bacilare)	43	1.54
Dizenteri amebike	0	0
Toksikoinfeksione alimentare	115	4.11
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	4526	161.63
Semundjet diarreike ne total	4715	168.38

### ➤ Zoonozat

Ne nivel vendi incidenca e Brucelozës është 0.54/100.000 banore. Rastet për muajin Prill 2018 janë raportuar nga rrethet Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lushnjë, Mallakastër, Pogradec, Shkodër dhe Tepelene. Antraksi, Leptospiroza dhe Rikeciet rezultojnë me 0 raste raportimi për muajin Prill 2018. Nga të dhënat e raportuara në muajin Prill 2018 rezultojnë 5 raste me TBC ekstrapulmonar dhe janë raportuar nga Tirane.


Tabela 2: Zoonozat në Prill 2018 (Incidenca raste/100.000 banore)

	Raste, Prill 2018	Incidenca Prill 2018 (raste/100.000 banore)
Antraks (Plasje)	0	0
Brucelozë	15	0.54
Leptospirozë	0	0
TBC ekstrapulmonar	5	0.18
Rikecie	0	0

### ➤ Fruthi

Gjate muajit Prill 2018 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë konfirmuar me IgM pozitiv 249 raste nga 545 raste që janë dyshuar në total. Rastet janë konfirmuar në Laboratorin e Virologjisë, ISHP.

Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve të dyshuara për fruth sipas datës së fillimit të rashit, Prill 2018



Rastet i përkasin kryesisht moshës pediatrike (<1 vjeç) moshe që sipas kalendarit të vaksinimit nuk e ka kryer dozën e parë të FRP. Peshën kryesore sipas shpërndarjes gjeografike të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me fruth e mban Tirana, Lezha, Kukësi dhe Durrësi.


### ➤ Meningoencefalite

Gjate muajit Prill 2018 janë raportuar në total 3 raste me meningoencefalite përkatësisht 2 raste me meningit bakterial meningokoksik dhe një rast me encefalit paspecifikuar. Te gjitha rastet janë të gjinisë meshkuj. Dhe me predominim në grupmoshën e rritur. Rastet paraqiten me një shpërndarje gjeografike në rrethet Lushnjë, Shkodër dhe Tiranë.

### ➤ Hepatitët virale

Në raportimin mujor të semundshmerise infektive gjate muajit prill 2018 janë raportuar në total 16 raste me hepatite virale akute (Incidenca 0.57/100.000 banorë) nga të cilat 10 raste janë Hepatite virale të paspecifikuara dhe 5 raste me Hepatit viral akut B dhe një hepatit viral as A as B.

Grafiku 2. Incidencat e rasteve me Hepatite virale akute, Prill 2018



Në lidhje me HBV, 5 rastet i përkasin grupmoshave 35-44 vjeç (3 raste) dhe grupmoshave 55-64 vjeç (2 raste). Në grupmoshën < 1 vjeç kemi tre raste me Hepatite virale të paspecifikuara.

### ➤ Tuberkulozi pulmonar

Gjate muajit Prill 2018 janë raportuar 29 raste me Tuberkuloz pulmonar me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës mujore 14/Sh nga DRSHP-te dhe DSHP-te. Vihet re nga të dhënat e ardhura në ISHP që peshën më të madhe të rasteve e mban Tirana (12 raste), Lezha (4 raste), Lushnja dhe Elbasani me 3 raste, Durrësi dhe Shkodra me 2 raste dhe Bulqizë, Diber, dhe Fier përkatësisht me një rast. Grupmosha Grupmosha me e prekur është 15-65+ vjeç. Nga 29 raste të suspektuara 15 janë të konfirmuar me Tuberkuloz pulmonar.

Hartoi: **Departamenti i Kontrollit te Sëmundjeve Infektive, Sektori i Epidemiologjisë.**

Silvia Bino, Eugena Tomini, Artan Simaku, Adela Vasili, Luljeta Alla, Elona Kureta, Rovena Daja, Marjeta Dervishi.

Editoi: Rovena Daja

INSTITUTI I  
SHENDETIT PUBLIK

DEKSI